535	06.10.2023	Miratimin e vijimit të procedurës së legalizimit me objekt “Shtesë 1 kat mbi objektin ekzistues 2 kate”, ndodhur Brenda kufirit të Qendrës Historike të qytetit të Korçës, me subjekt aplikues Znj. Mimoza Bicoll;	ASHK Korçë
536	06.10.2023	Mosmiratimin e vijimit të procedurës së legalizimit me objekt “Shtesë anësore në objekt ekzistues me leje ndërtimi 2 kate”, Brenda kufirit të Zonës Arkeologjike “A” të qytetit të Sarandës, me subjekt aplikues Z. Xhido Xheka për arsye se; a) Objekti informal, çënon integritetin e pasurive kulturore të paluajtshme të grupuara, Zonë Arkeologjike “A”, sipas VKM Nr. 1040, datë 25.11.2020 “Për përcaktimin e rregullave të zbatimit të kriterëve të legalizimit dhe miratimin e modelit të aktit të legalizimit, për ndërtimet pa leje” Kreu II, pika 15 gërma ë);	ASHK Sarandë



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E KULTURËS

537	06.10.2023	Mosmiratimin e vijimit të procedurës së legalizimit me objekt “Objekt 1 kat”, i ndodhur Brenda kufirit të Zonës së Mbrojtur të pasurisë kulturore “Hamami i Pazarit”, Monument Kulture i Kategorisë I-rë, Elbasan, me subjekt aplikues Znj. Elena Aleksandër Marku për arsye se; a) Objekti informal, çënon vëllimin/ pamjen e jashtme të monumentit të kulturës pasi pozicionohet brenda kufirit të zonës së mbrojtur të pasurisë kulturore “Hamami i Pazarit”, Monument kulture i kategorisë I-rë, Elbasan sipas VKM Nr. 1040, datë 25.11.2020 “Për përcaktimin e rregullave të zbatimit të kriterëve të legalizimit dhe miratimin e modelit të aktit të legalizimit, për ndërtimet pa leje” Kreu II, pika 15, gërma dh);	ASHK Elbasan
538	06.10.2023	Miratimin e projektit “Restaurimi i banesës ku lindi dhe kaloi disa vite të fëmijërisë Aleksandër Moisiu (Muzeu Etnografik i Durrësit)”, Monument Kulture i Kategorisë së I-rë, , me rekomandimin; a) Gjatë implementimit të projektit t’i kushtohet rëndësi e veçantë strukturës së objektit. Në rast se, evidentohen problematika të paparashikuara, projekti të risillet me propozimet e reja për miratim në KKTKM;	ZYRA UNOPS NË SHQIPËRI
539	08.11.2023	Miratimin e projektit “Rishikim pjesor i projektit “Ndërrhyrje restaurimi/ mirëmbajtjeje në rreshtin e parë të mureve që kufizojnë Qendrën Mesjetare të qytetit të Beratit (paketë mirëmbajtjeje nr. 1 ndërrhyrje në mure, porta dhe fasada)”, Brenda Kufirit Qendër Historike Berat,	DRTK Berat;
540	08.11.2023	Miratimin e projektit “Restaurimin, Rikonstruksionin dhe Muzealizimin e Muzeut Historik Kombëtar, Tiranë”, Monument Kulture i Kategorisë së II-të,	ZYRA UNOPS NË SHQIPËRI
541	08.11.2023	Miratimin e projektit “Restaurimi i Tyrbes së Nuses, Tiranë”, Monument Kulture i Kategorisë së I-rë;	Bashkia Tiranë;
542	08.11.2023	Miratimin nw parim të “Planit të Integruar të Menaxhimit të Zonës Arkeologjike “A” dhe “B”, Durrës, të rishikuar, financuar nga Fondacioni Shqiptaro – Amerikan i Zhvillimit (AADF), hartuar nga konsulenti A.R.S Progetti S.P.A;	hartuar nga konsulenti A.R.S Progetti S.P.A;
543	08.11.2023	Miratimin e projektit “Projektimet e Detajuara dhe Mbikëqyrja e Ndërtimit për Infrastrukturat për Pikat Panoramike përgjatë qarkut turistik në Shqipërinë e Jugut, Dizajni i konceptit, udhëzimet, vlerësimet paraprake, plani paraprak i menaxhimit dhe mirëmbajtjes për projektet e përzgjedhura të investimeve Shqipëria e Jugut”, Xarrë”, Brenda Kufirit Zonë Arkeologjike “B”,	FONDI SHQIPTAR I ZHVILLIMIT(FSHZH);
544	08.11.2023	Miratimin e Konceptit i gërmimit arkeologjik “Për gjetjet arkeologjike në shkollën Gjergj Kastrioti”, Brenda Zonës Arkeologjike “B” Durrës, realizuar nga subjekti i licencuar z Luan Përzhita,	Bashkia Durrës.
545	08.11.2023	Miratimin e projektit “Vazhdim i gërmimeve në varrezën në zonën e portës jug-lindore në fortifikimin e Grazhdanit”, në kuadër të projekteve kërkimore – shkencore në vazhdim me drejtues projekti prof. Luan Përzhita,	AKADEMIA E STUDIMEVE ALBANOLOGJIKE;
546	08.11.2023	Miratimin e projektit “Transformimi i një qyteti ilir gjatë antikitetit të vonë dhe mesjetë në qytetin ilir në Zgërdhesh”, në kuadër të projekteve kërkimore – shkencore në vazhdim me drejtues projekti prof. Elvana Metalla,	AKADEMIA E STUDIMEVE ALBANOLOGJIKE;
547	08.11.2023	Miratimin e projektit “Lugina e Poshtme e Drinit në Mesjetë”, në kuadër të projekteve kërkimore – shkencore në vazhdim, me drejtues projekti prof. Elvana Metalla,	AKADEMIA E STUDIMEVE ALBANOLOGJIKE;
548	08.11.2023	Miratimin e projektit “Varret shkëmbore të Matit” dhe territori i tyre - studime arkeologjike në pellgun ujëmbledhës të lumit të Matit”, në kuadër të projekteve kërkimore – shkencore në vazhdim, me drejtues projekti prof. Ols Lafe,	Ols Lafe;
549	08.11.2023	Miratimin në parim të propozimit të ardhur nga IKTK për vënien në “Mbrojtje Paraprake” të objektit “Vila mbretnore në Shirokë, Shkodër”,	IKTK
550	08.11.2023	Miratimin e Raportit të vëzhgimit arkeologjik sipërfaqësor në kuadër të projektit “Kompleks me vila 2 kat, me 1 kat nëntokë, me mure rrethuese, në njësinë strukturore FA /77 Tiranë”, Bashkia Tiranë,	F.Z.CONSTRUCTION sh.p.k.”
551	08.11.2023	Miratimin e Raportit të vëzhgimit arkeologjik sipërfaqësor në kuadër të projektit “Ndërtimin, shfrytëzimin dhe administrimin e centralit gjenerues	G.S.K sh.p.k.;



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E KULTURËS

		të energjisë elektrike fotovoltaike, me kapacitet të instaluar 2MW dhe veprave ndihmëse”, në Zonën Kadastrale 3038, Njësia Administrative Dermentas, Bashkia Fier,	
552	08.11.2023	Miratimin e Raport i vëzhgimit arkeologjik sipërfaqësor në kuadër të projektit “Objekt 2 kate me funksion industri dhe mur rrethues”, Njësia Administrative Kashar, Njësia Strukturore KA/196, në pronësi të z. Behar Sinamati, Bashkia Tiranë”,	SINAMATI GROUP;
553	08.11.2023	Miratimin e Raport i vëzhgimit arkeologjik sipërfaqësor në kuadër të projektit “Green Coast Resort II, Zona G8, Hotel dhe njësi shërbimi me 1, 2, 3, 4 dhe 6 kate mbi tokë dhe 1 kat nëntokë”,	SEASIDE HOTEL sh.p.k;
554	08.11.2023	Miratimin e Raport i vëzhgimit arkeologjik sipërfaqësor në kuadër të projektit “Kompleks me vila individuale 1,2 dhe 3 kat me 1 kat nëntokë, banesa kolektive 2 dhe 3 kat me 1-2 kate nëntokë dhe mur rrethues, Njësia strukturore FA/60 dhe FA/30, Njësia Administrative Farkë, në pronësi të z. Klajd Nano, z. Fatmir Draci,	JOY GROUP Sh.a.;
555	08.11.2023	Miratimin e Raport i vëzhgimit arkeologjik sipërfaqësor në kuadër të projektit “Strukturë shërbimi - hotel me 1 deri 6 kate dhe 3 deri 7 kate nëntokë, Njësia Strukturore HI.UB.1.750, me vendndodhje Bashkia Himarë,	WHITE ROADS HOTEL sh.p.k;
556	08.11.2023	Miratimin e kërkesës së Z. Stavri Burda për pajisje me Licencë individuale në Projektim (P), në veprimtari ndërhyrëse në pasuri kulturore materiale për kategorinë (A), në nënkategoritë ;	Kërkesë e Z. Stavri Burda
557	08.11.2023	Miratimin e kërkesës së Z. Stavri Burda për pajisje me Licencë individuale në Zbatim (Z), në veprimtari ndërhyrëse në pasuri kulturore materiale për kategorinë (A), në nënkategoritë: - Z/A/2. Zbatim në konservim dhe restaurim i ndërtimeve me karakter mbrojtës; - Z/A/5. Zbatim në konservim dhe restaurim i arkitekturës së traditës (vernakulare);	Kërkesë e Z. Stavri Burda
558	08.11.2023	Miratimin e kërkesës së Znj. Zamira Merxhani për pajisje me Licencë individuale në Projektim (P), në veprimtari ndërhyrëse në pasuri kulturore materiale për kategorinë (A), në nënkategoritë ; P/A/5. Projektim në konservim dhe restaurim i arkitekturës së traditës (vernakulare); P/A/7. Projektim në konservim, restaurim dhe rikualifikim i hapësirave (rruge, sheshe) brenda qendrave historike dhe ansambleve historike urbane;	Kërkesë e Znj. Zamira Merxhani
559	08.11.2023	Mosmratimin e kërkesës së Znj. Zamira Merxhani për pajisje me Licencë individuale në Zbatim (Z), në veprimtari ndërhyrëse në pasuri kulturore materiale për kategorinë (A),	Kërkesë e Znj. Zamira Merxhani
560	08.11.2023	Miratimin e vijimit të procedurës së legalizimit për Objekt banimi 1 kat”, Brenda Zonës Arkeologjike “A” të qytetit të Vlorës, me subjekt aplikues Z. Nebi Asqeri;	ASHK Vlorë
561	08.11.2023	Miratimin e vijimit të procedurës së legalizimit për “Shtesë anësore dhe në lartësi në objekt ekzistues 3-4 kate”, Brenda Zonës Arkeologjike “A” të qytetit të Vlorës, me subjekt aplikues Z. Nesip Pëllumb Jaupaj;	ASHK Vlorë
562	17.11.2023	Shtyrje vendimarrje për projektin “Restaurimi dhe konsolidimi i Varreve “Varroshi”, Vergo, Delvinë”, Monument Kulture i Kategorisë së I-rë, , me argumentin: - Mos prezenca e autorit të projektit në mbledhje për argumentimin teknik të propozimeve të dhëna në projekt për restaurimin e kësaj pasurie kulturore;	DRTK Vlorë
563	17.11.2023	Miratimin e Termave të Referencës për “Menaxhimin e Trafikut, Transportit dhe Menaxhimi i Vizitorëve”, Pasuria Kulturore Parku Kombëtar i Butrintit,	me kërkesë të Fondacionit Shqiptaro – Amerikan i Zhvillimit (AADF);
564	17.11.2023	Miratimin e Termave të Referencës për “Shëndetin dhe Sigurinë, menaxhimi i fatkeqësive dhe plani i sigurisë së sitit”, Pasuria Kulturore Parku Kombëtar i Butrintit,	me kërkesë të Fondacionit Shqiptaro – Amerikan i Zhvillimit (AADF);
565	17.11.2023	iratimin e Termave të Referencës për “Planin e konservimit”, Pasuria Kulturore Parku Kombëtar i Butrintit), me rekomandimin; • Gjatë hartimit të Planit të Konservimit, përveç faktorëve klimaterikë, të merren në konsideratë edhe faktorët e tjerë: - Faktori kohë;	me kërkesë të Fondacionit Shqiptaro – Amerikan i Zhvillimit (AADF);



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E KULTURËS

		- Faktori sizmik; - Faktori njeri; - Fauna dhe flora; - Fatkeqësi natyrore (zjarri....etj);	
566	17.11.2023	Miratimin e Termave të Referencës për “Studimin Hidrologjik dhe ekologjik”, Pasuria Kulturore Parku Kombëtar i Butrinti,	me kërkesë të Fondacionit Shqiptaro – Amerikan i Zhvillimit (AADF);
567	17.11.2023	Miratimin e projektit “Shkëputja, restaurimi dhe përgatitja për ekspozim i mozaikut me meandër, Durrës”, pjesë e Monumentit të Kulturës Kategori e I-rë me titull “Rrënojat e ndërtesës me mozaik”, Brenda Kufirit të Zonës Arkeologjike “B” Durrës	DRTK Tiranë/ Ministria e Kulturës;
568	17.11.2023	Shtyrje vendimmarrje të projektit “Shtesë kati i dytë banimi dhe përshtatje volumi e fasade” banesë Z. Zylyftar Rokaj lagjia “13 Shtatori”, Brenda Kufirit Zonë e Mbrojtur e Qendrës Historike Berat, , me argumentin: - Të rishikohet projekti duke ritrajtuar dhe thjeshtëzuar elementët arkitektonik në fasadë.	Z. Zylyftar Rokaj
569	17.11.2023	Miratimin e projektit “Rikonstruksion i objektit ekzistues”, Brenda Kufirit Zonë Arkeologjike “A” Durrës,	Z. Artur Troplini.
570	17.11.2023	Miratimin e projektit “Prishje e objektit ekzistues dhe rindërtimi i objektit të ri mbi gjurmën e objektit ekzistues banim 1 katësh me tarracë” me vendndodhje lagjia 2, rruga “Telha Çela”, Bashkia Durrës, Brenda Kufirit Zonë Arkeologjike “A” Durrës,	Z. Fatmir Shehu.
571	17.11.2023	Miratimin e deklarimit të interesit kulturor për objektin “Banesa nr. 54, Kala, Krujë” dhe dhënien e statusit të mbrojtjes “Monument Kulture i kategorisë së II-të”,	DRTK Tiranë
572	17.11.2023	Miratimin e deklarimit të interesit kulturor për objektin “Banesa nr. 66, Kala, Krujë” dhe dhënien e statusit të mbrojtjes “Monument Kulture i kategorisë së II-të”,	DRTK Tiranë
573	17.11.2023	Miratimin e Raportit të dokumentimit të gjetjeve arkeologjike gjatë monitorimit arkeologjik në Zonën 1 të projektit “Voskopole Resort”, hartuar nga subjekti i licencuar z. Taulant Rama,	“Selmani Construction” sh.p.k.;
574	17.11.2023	Miratimin e Raportit i Vëzhgimit Arkeologjik Sipërfaqësor në kuadër të projektit “Strukturë akomoduese rezidenciale dhe Marina Resort, Vlorë” blloku 5 (objekti B2)”,	Marina Residences Vlorë sh.p.k.;
575	17.11.2023	Miratimin e Raportit i Vëzhgimit Arkeologjik Sipërfaqësor në kuadër të projektit “Kompleks magazinimi dhe tregtimi i produkteve bujqësore dhe pentarisë”, me vendndodhje Bashkia Durrës,	Naim Tragaj Group sh.p.k.;
576	17.11.2023	Miratimin e Raportit i Vëzhgimit Arkeologjik Sipërfaqësor në kuadër të projektit “Geopoint kompleks vilash individuale 2 kate, PT/27, Tiranë”, me vendndodhje në rrugën “Hekal Qeha”,	“GEO - POINT. AL” sh.p.k.;
577	17.11.2023	Miratimin e vijimit të procedurës së legalizimit për objektin “Shtesë në lartësi mbi objektin ekzistues 5 kat”, Tiranë, me subjekt aplikues Z. Ervin Nasip Meçaj;	ASHK Tiranë
578	17.11.2023	Mosmiratimin e kërkesës së Z. Erdal Çeçen për pajisje me Licencë individuale në Projektim (P), në veprimtari ndërhyrëse në pasuri kulturore materiale, për nënkategoritë për të cilat ka aplikuar (P/A/1; P/A/2; P/A/3; P/A/4; P/A/5; P/A/6; P/A/7), pasi nuk plotëson numrin e projekteve të depozituara në konservim/restaurim, si autor/bashkëautor në secilën nënkategori:	Kërkesë e Z. Erdal Çeçen
579	17.11.2023	Miratimin e kërkesës së Z. Luçjano Bojaxhiu për pajisje me Licencë individuale në Projektim (P), në veprimtari ndërhyrëse në pasuri kulturore materiale për kategorinë (A), në nënkategoritë: - P/A/1. Projektim në konservim dhe restaurim i rrënojave/ siteve arkeologjike; - P/A/2. Projektim në konservim dhe restaurim i ndërtimeve me karakter mbrojtës; - P/A/3. Projektim në konservim dhe restaurim i arkitekturës së kultit; - P/A/4. Projektim në konservim dhe restaurim i ndërtimeve inxhinierike; - P/A/5. Projektim në konservim dhe restaurim i arkitekturës së traditës (vernakulare);	Kërkesë e Z. Luçjano Bojaxhiu



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E KULTURËS

		- P/A/6. Projektim në konservim dhe restaurim i arkitekturës se projektuar; - P/A/7. Projektim në konservim, restaurim dhe rikualifikim i hapësirave (rrugë, sheshe) brenda qendrave historike dhe ansambleve historike urbane;	
580	17.11.2023	Miratimin e kërkesës së Z. Luçjano Bojaxhiu për pajisje me Licencë individuale në Zbatim (Z), në veprimtari ndërhyrëse në pasuri kulturore materiale për kategorinë (A), në nënkategoritë: - Z/A/1. Zbatim në konservim dhe restaurim i rrënojave/ siteve arkeologjike; - Z/A/2. Zbatim në konservim dhe restaurim i ndërtimeve me karakter mbrojtës; - Z/A/3. Zbatim në konservim dhe restaurim i arkitekturës së kultit; - Z/A/4. Zbatim në konservim dhe restaurim i ndërtimeve inxhinierike; - Z/A/5. Zbatim në konservim dhe restaurim i arkitekturës se traditës (vernakulare); - Z/A/6. Zbatim në konservim dhe restaurim i arkitekturës se projektuar; - Z/A/7. Zbatim në konservim, restaurim dhe rikualifikim i hapësirave (rrugë, sheshe) brenda qendrave historike dhe ansambleve historike urbane;	Kërkesë e Z. Luçjano Bojaxhiu
581	17.11.2023	Miratimin e kërkesës së Z. Luçjano Bojaxhiu për pajisje me Licencë individuale në Mbikëqyrje dhe Kolaudim (MK), në veprimtari ndërhyrëse në pasuri kulturore materiale për kategorinë (A), në nënkategoritë: - MK/A/2. Mbikëqyrje dhe kolaudim në konservim dhe restaurim i ndërtimeve me karakter mbrojtës; - MK/A/3. Mbikëqyrje dhe kolaudim në konservim dhe restaurim i arkitekturës së kultit; - MK/A/6. Mbikëqyrje dhe kolaudim në konservim dhe restaurim i arkitekturës se projektuar; - MK/A/7. Mbikëqyrje dhe kolaudim në konservim, restaurim dhe rikualifikim i hapësirave (rrugë, sheshe) brenda qendrave historike dhe ansambleve historike urbane;	Kërkesë e Z. Luçjano Bojaxhiu
582	01.12.2023	Miratimin e projektit “Ndërrhyrje emergjente konservuese në kishën e Shën Kollit Dhuvjan, Gjirokastrë”, Monument Kulture i Kategorisë së I-rë,	DRTK Gjirokastrë;
583	01.12.2023	Miratimin e projektit “Restaurimi dhe rikualifikimi urban i zonës perspektive TID të gjendur në Parkun Arkeologjik të Durrësit”, Brenda Kufirit Zonë Arkeologjike “A”, me vendndodhje Bashkia Durrës,	Bashkia Durrës.
584	01.12.2023	Miratimin e “Rishikimit pjesor të projektit “Dizënjimi për rivitalizimin e sheshit “Çerçiz Topulli” dhe parkimin nëntokësor, në Pazarin e vjetër të Gjirokastrës”, Brenda Qendrës Historike Gjirokastrë, me vendndodhje Bashkia Gjirokastrë,	Fondi Shqiptar i Zhvillimit;
585	01.12.2023	Miratimin e “Raportit të sondeheve Arkeologjike në kuadër të projektit “Kompleks turistik me shtëpi pushimi, shërbime dhe hotel 5*, Zvërnec, Vlorë, Shqipëri”, Brenda Zonës së Mbrojtur të Qytetit antik Triport, Monument Kulture i kategorisë së I-rë,	Green Investment sh.p.k;
586	01.12.2023	Mosmiratim për projektin “Ndërtim objekte druri në pronat 4/948 ,4/949 dhe 4/947 ne Lagja Spitalit, Lezhë”, Brenda Kufirit Zonë Arkeologjike “A” Lezhë, me vendndodhje Bashkia Lezhë, hartuar nga individ i licencuar z. Alfred Gjoni, me argumentin: - Projekti bie në kundërshtim me VKM Nr. 728, datë 01.09.2010, “Për shpalljen e Zonave Arkeologjike “A” dhe “B” të qytetit të Lezhës dhe miratimin e rregullores së administrimit”, neni 3 (ndërrhyrjet e lejuara në zonën arkeologjike “A” të qytetit të Lezhës), pika 3;	Znj, Kostandina Resuli
587	01.12.2023	Miratimin e “Raportit Arkeologjik në kuadër të projektit “Rikonstruksion objekti ekzistues 3 dhe 2 kat me ndryshim funksioni, dhe shtesë në katin përdhe”, banesa e z. Lum-mir Frashëri”, Brenda Kufirit Zonë Arkeologjike “B” Durrës, me vendndodhje Bashkia Durrës, hartuar nga individ i licencuar z. Taulant Rama,	z, Lum-mir Frashëri;



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E KULTURËS

588	01.12.2023	Miratimin e "Raportit të Vëzhgimit Arkeologjik Sipërfaqësor në kuadër të projektit "Kompleks me banesa individuale 1, 2 dhe 3 kat mbi tokë dhe 1 kat nëntokë, me mure rrethuese dhe pishinë", Mjull Bathore, Bashkia Tiranë", hartuar nga individ i licencuar z. Taulant Rama,	"Anchor Investments" sh.p.k.;
589	01.12.2023	Miratimin e "Raportit të Vëzhgimit Arkeologjik Sipërfaqësor në kuadër të projektit "Strukturë akomoduese rezidenciale dhe Marina Resort, Vlorë" Blloku 3 (objekti C4)", me vendndodhje Bashkia Vlorë, hartuar nga subjekt i licencuar "I RI",	Marina Residences Vlorë sh.p.k.;
590	01.12.2023	Miratimin e Raportit të Vëzhgimit Arkeologjik Sipërfaqësor në kuadër të projektit "Strukturë akomoduese rezidenciale dhe Marina Resort, Vlorë" Blloku 3 (objekti C5, objekti D4)", me vendndodhje Bashkia Vlorë, hartuar nga subjekt i licencuar "I RI",	Marina Residences Vlorë sh.p.k.;
591	01.12.2023	Miratimin e "Raportit të Vëzhgimit Arkeologjik Sipërfaqësor në kuadër të projektit "Centralet prodhuese të energjisë", me vendndodhje Bashkia Lushnje, hartuar nga individ i licencuar z. Taulant Rama, me zhvillues 5GX Energy sh.p.k.;	5GX Energy sh.p.k.;
592	01.12.2023	Miratimin e kërkesës së subjektit "Atelier 4" sh.p.k. për ndryshim të përfaqësuesit ligjor në licencën për Mbikëqyrje dhe Kolaudim (MK), në veprimtari ndërhyrëse në pasuri kulturore materiale;	Kërkesë e Atelier 4
593	01.12.2023	Miratimin e kërkesës së subjektit "Atelier 4" sh.p.k. për ndryshim të përfaqësuesit ligjor në licencën për Projektim (P), në veprimtari ndërhyrëse në pasuri kulturore materiale;	Kërkesë e Atelier 4
594	01.12.2023	Miratimin e kërkesës së subjektit "Lior Construction" sh.p.k. për pajisje me Licencë për personin juridik (N) në zbatim (Z) në veprimtari ndërhyrëse në pasuritë kulturore materiale, në kategoritë (A), me drejtues teknik Z. Dorian Ceribashi, në nënkategoritë: ☐ N - Z/A/2. Zbatim në konservim dhe restaurim i ndërtimeve me karakter mbrojtës; ☐ N - Z/A/5. Zbatim në konservim dhe restaurim i arkitekturës së traditës (vernakulare); ☐ N - Z/A/6. Zbatim në konservim dhe restaurim i arkitekturës së projektuar; ☐ N - Z/A/7. Zbatim në konservim, restaurim dhe rikualifikim i hapësirave (rugë, sheshe) brenda qendrave historike dhe ansambleve historike urbane;	Kërkesë e "Lior Construction
595	12.12.2023	Mosmiratimin e Raportit të vlerësimit mbi potencialin arkeologjik në kuadër të projektit "Rindërtimi i hotelit 4 kat+1kat nën tokë", Brenda Kufirit Zonë Arkeologjike "A" Durrës, me vendndodhje Bashkia Durrës, hartuar nga subjekt i licencuar "JF Architectural Designer", me argumentin: - Projekti bie në kundërshtim me VKM Nr. 786 datë 26.12.2018 "Për miratimin e Zonave arkeologjike "A" dhe "B" të qytetit të Durrësit dhe të planit për ruajtjen, mbrojtjen dhe administrimin e tyre", neni 3, gërma d).	Z. Nedi Ismaili
596	12.12.2023	Miratimin e Raportit të Potencialit Arkeologjik në kuadër të projektit "Projekt Model për Rindërtimin e Shtëpisë Individuale", Brenda Kufirit Zonë Arkeologjike "B" Durrës, me vendndodhje Bashkia Durrës, hartuar nga subjekt i licencuar "JF Architectural Designer",	z. Riza Shuli;
597	12.12.2023	Miratimin e Raportit të vlerësimit mbi potencialit arkeologjik në kuadër të projektit "Rikonstruksion i objektit ekzistues 1-kat , dhe shtesë 1-kat me çati", Brenda Kufirit Zonë Arkeologjike "B" Durrës, me vendndodhje Bashkia Durrës, hartuar nga subjekt i licencuar në arkeologji z. Skënder Bushi,	z. Idriz Çyrbja;
598	12.12.2023	Miratimin e Raportit të Vëzhgimit Arkeologjik Sipërfaqësor në kuadër të projektit "Objekt me funksione komplekse, shërbimi, hoteleri dhe rezidenciale, në 5, 6 dhe 25 kate mbitokë dhe 5 kate parkim nëntokë, me vendndodhje në rrugën "Liman Kaba", Tiranë", me vendndodhje Bashkia Tiranë, hartuar nga individ i licencuar znj. Silvana Kita,	Unico Construction sh.p.k.;
599	12.12.2023	Miratimin e Raportit të Vëzhgimit Arkeologjik Sipërfaqësor në kuadër të projektit "Godinë industriale me 1 dhe 2 kate mbi tokë", me vendndodhje Bashkia Tiranë, hartuar nga individ i licencuar z. Taulant Rama,;	s z. Petrit Kasapi;



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E KULTURËS

600	12.12.2023	Miratimin e Raportit të Vëzhgimit Arkeologjik Sipërfaqësor në kuadër të projektit "Kompleks banimi 2 kate me 1 kat nëntokë me mur rrethues", në pasurinë me nr. 346/52, 346/53, 346/54, 346/63, Zona Kadastrale 1605", me vendndodhje, Njësia Administrative Farkë, Bashkia Tiranë", hartuar nga individ i licencuar z. Gjergj Vinjahu,	Magna Construction sh.p.k.;
601	12.12.2023	Miratimin e Raportit të Vëzhgimit Arkeologjik Sipërfaqësor në kuadër të projektit "Kompleks banimi 2-3 kat me 1 kat pjesërisht nëntokë me mur rrethues", Njësia Administrative Farkë", me vendndodhje Bashkia Tiranë, hartuar nga individ i licencuar z. Elio Hobdari,	Bevea Group;
602	12.12.2023	Miratimin e Raportit të Vëzhgimit Arkeologjik Sipërfaqësor në kuadër të projektit "Strukturë akomoduese rezidenciale dhe Marina Resort, Vlorë" Blloku 4 (objekti C3)", me vendndodhje Bashkia Vlorë, hartuar nga individ i licencuar në arkeologji znj. Iris Pojani	Marina Residences Vlorë sh.p.k.;
603	12.12.2023	Miratimin e Raportit të Vëzhgimit Arkeologjik Sipërfaqësor në kuadër të projektit "Kompleks me hoteleri dhe apartamente me shërbime turistike, 4 kate me tarracë të shfrytëzueshme, 1 kat nëntokë, pishinë dhe mur rrethues", me vendndodhje Rradhimë, Bashkia Vlorë, hartuar nga subjekt i licencuar në arkeologji znj. Silvana Kita,	FEBI sh.p.k.;
604	12.12.2023	Miratimin e Raportit të Vëzhgimit Arkeologjik Sipërfaqësor në kuadër të projektit "Strukturë agroturizëm dhe hoteleri 1, 2 kate, Gjollë, ", me vendndodhje Bashkia Himarë, hartuar nga individ i licencuar në arkeologji znj. Iris Pojani	Abeille's Resort sh.p.k.;
605	12.12.2023	Miratimin e Raportit të Vëzhgimit Arkeologjik Sipërfaqësor në kuadër të projektit "Kompleks vila banimi 1 dhe 2 kate mbi tokë, me 1 kat nëntokë, me mur rrethues dhe pishinë" në pasuritë nr. 307/38, 133/9, 307/37, 133/8, Zona Kadastrale 2735, në Njësine Strukturore PT/31, Njësia Administrative Petrelë" Bashkia Tiranë, hartuar nga individ i licencuar në arkeologji znj. Iris Pojani,	Prime Capital sh.p.k.;
606	12.12.2023	Miratimin e Raportit të Vëzhgimit Arkeologjik Sipërfaqësor në kuadër të projektit "Ndërtim i infrastrukturës së rrjetit kabllor fibër optike, FTTH, Bashkia Lezhë", hartuar nga individ i licencuar z. Taulant Rama,	Vodafone Albania sh.a.;
607	28.12.2023	Shtyrjen e vendimmarrjes për projektin "Restaurim dhe konservim i pjesshëm, në fasadën e objektit "Galeria e Arteve, ish Bashkia e Qytetit të Shkodrës", Monument Kulture i Kategorisë së I-rë, me vendndodhje Bashkia Shkodër, , me argumentin: - Të plotësohet projekti me material arkivor për sa i takon elementit të dritares.	DRTK Shkodër
608	28.12.2023	Miratimin e Projektit "Rethimi i Adrianopolit pranë fshatit Sofratike", Monument Kulture i Kategorisë së I-rë, me vendndodhje Bashkia Gjirokastrë,	DRTK Gjirokastrë;
609	28.12.2023	Miratimin e Projektit "Ndërrhyrje restauruese e konsoliduese në Rrënojat e Kishës në Çiflik, Bashkia Konispol", Monument Kulture i Kategorisë së I-rë, me vendndodhje Bashkia Vlorë,	DRTK Vlorë;
610	28.12.2023	Miratimin e Termave të Referencës për "Planin e Menaxhimit të Destinacionit Turistik Kalaja e Beratit", me kërkesë të Fondacionit Shqiptaro – Amerikan i Zhvillimit (AADF);	me kërkesë të Fondacionit Shqiptaro – Amerikan i Zhvillimit (AADF);
611	28.12.2023	Miratimin e "Planit të Menaxhimit për Ish - Burgun e Spaçit", Munument Kulture i Kategorisë së II-të, me kërkesë të Organizatës "Trashëgimia Kulturore pa Kufij-Shqipëri" (CHwB Albania);	me kërkesë të Organizatës "Trashëgimia Kulturore pa Kufij-Shqipëri" (CHwB Albania);
612	28.12.2023	Miratimin në parim të Koncept-idesë për Projektin "Qendra e Vizitorëve Butrint", Brenda Kufirit Pasuri Kulturore "Parku Kombëtar i Butrintit",	Organizata "Trashëgimia Kulturore pa Kufij-Shqipëri" (CHwB Albania);
613	28.12.2023	Miratimin në parim të Projekt idesë për "Projektimin, restaurimin dhe muzealizimin e ish banesës së Toptanasve/ Libohovitët, "Muzeu Besa", Monument Kulture i Kategorisë së I-rë, me vendndodhje Bashkia Tiranë,	Ministria e Kulturës;
614	28.12.2023	Miratimin e Projekti "Mbi disa ndryshime në projektin e ndërtesës "Komiteti Mbrojtja Kombëtare e Kosovës", Monument Kulture Kategoria e II-të",	Z. Arben Rroji;
615	28.12.2023	Shtyrjen e vendimmarrjes për Projektin "Ndërtesë Polifunkionale+hidroterapi (3 kat+bodrum) investitor Instituti i motrave	znj. Dukata Radoja



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E KULTURËS

		Stigmatine, Brenda Kufirit Qendër Historike Shkodër, me vendndodhje Bashkia Shkodër, a, me argumentin se: - Aplikimi duhet të plotësohet me dokumentacion tekniko-ligjor për sa i takon pronësisë, projektit teknik dhe të gjithë komponentëve të tij; - Projekti ti referohet Vendimit Nr. 771, Datë 30.09.2020 “Për deklarimin Pasuri Kulturore të “Qendrës Historike” të Qytetit të Shkodrës, Përcaktimin e Zonës Mbrojtëse të saj dhe Miratimin e Planit për ruajtjen, Mbrojtjen dhe Administrimin e tyre”, Neni 10, pika 2.	
616	28.12.2023	Miratimin e Projektit “Restaurimi dhe Rijetëzimi i banesës me kod M-41 “Guest House Kalo”, lagjia Mangalem, Berat”, Monument Kulture i Kategorisë së II-të, Brenda Kufirit Qendër Historike Berat,	Z. Parid Kalo;
617	28.12.2023	Shtyrjen e vendimarrjes për projektin “Rikonstruksion i objektit ekzistues shërbimi 3 kat, Dhërmi”, Brenda Kufirit Zonë e Mbrojtur e Qendrës Historike Dhërmi, me vendndodhje Bashkia Vlorë, , me argumentin se: - Projekti duhet të vijë në përputhje me Vendimin Nr. 29, Datë 20.01.2016 “Për Shpalljen e Qendrës Historike të fshatit Dhërmi dhe miratimin e rregullores për administrimin e saj e të zonës së mbrojtur përreth”, Neni 6, Pika 3.	Mhill Ndreu
618	28.12.2023	Miratimin e Raportit të vlerësimit mbi potencialin arkeologjik në kuadër të projektit “Rikonstruksion me shtim volumi (shtesë 1 kat në objektin ekzistues)”, Brenda Kufirit Zonë Arkeologjike “B” Durrës, me vendndodhje Bashkia Durrës, hartuar nga person i licencuar z. Gjergj Vinjahu,	Z. Orget Çuku;
619	28.12.2023	Miratimin e Raportit të potencialit “Ndërtim çatie për rritje efience energjitike në objektin 1 kat në afërsi të ansamblit të rrugës “Justin Godard”, Vlorë”,	z. Qemal Lamçe;
620	28.12.2023	Miratimin e Projektit “Restaurim çatie në banesën individuale - Lagjie Kala”, Brenda Kufirit Zona Arkeologjike “A” Elbasan,	Endrit Kurmaku;
621	28.12.2023	Miratimin e Projektit “Restaurimi i objektit 2-kat Qendra Rinore dhe këshillimi i karrierës në Lagjen “Kala”, Brenda Kufirit Zona Arkeologjike “A” Elbasan,	Bashkia Elbasan;
622	28.12.2023	Miratimin e Raportit të vëzhgimit arkeologjik në kuadër të projektit “Objekt rezidencial banimi me 4 – 5 – 6 kate mbi tokë dhe 2 – 3 kate nën tokë për studentë” Rruga “Haxhi Dushku, Mjull Bathore, Njësia Administrative Farkë”, me vendndodhje Bashkia Tiranë, hartuar nga subjekt i licencuar në arkeologji z. Ylli Cerova,	Artan Dumi;
623	28.12.2023	Miratimin e Raportit të vëzhgimit arkeologjik në kuadër të projektit “Kampus Universitar me 2, 3 kate mbi tokë dhe 2, 3 kate nën tokë”, me vendndodhje Bashkia Tiranë, hartuar nga subjekt i licencuar në arkeologji z. Ylli Cerova,	Artan Dumi;
624	28.12.2023	Miratimin e Raportit të vëzhgimit arkeologjik sipërfaqësor në kuadër të projektit “Strukturë turistike dhe banimi me 8 kate ndërtim mbitokë dhe 1 kat parkim nëntokë”, në rrugën “Dhimitër Konomi”, Bashkia Vlorë, hartuar nga individ i licencuar në arkeologji znj. Iris Pojani,	Giga Konstruksion;
625	28.12.2023	Miratimin e Raportit të vëzhgimit arkeologjik sipërfaqësor në kuadër të projektit “Park Fotovoltaik 50 MW”, me vendndodhje në Sheq, Bashkia Fier, hartuar nga individ i licencuar në arkeologji znj. Iris Pojani,	Nova Solar System” sh.p.k.;
626	28.12.2023	Miratimin e Raportit të vëzhgimit intensiv arkeologjik sipërfaqësor në kuadër të projektit “Centrali Fotovoltaik 2MW Povelç 2”, Fushë Hoxharë, Bashkia Fier, hartuar nga individ i licencuar në arkeologji z. Taulant Rama,	“SUNPOWER 2017” sh.p.k.;
627	28.12.2023	Miratimin e Raportit të vëzhgimit intensiv arkeologjik sipërfaqësor në kuadër të projektit “Blok banimi me 1, 9 dhe 34 kate mbi tokë dhe 4 kate nëntokë”, me vendndodhje Rruga “Xhanfize Keko”, Bashkia Tiranë, hartuar nga individ i licencuar në arkeologji z. Taulant Rama,	“Anchor Investments”;
628	28.12.2023	Miratimin e Raportit të vëzhgimit arkeologjik sipërfaqësor në kuadër të projektit “Kompleks banimi me struktura 1, 2 dhe 3 kat, me 1 kat nëntokë, pishinë dhe mur rrethues”, të ndodhur në Lundër, Njësia Administrative Farkë, Njësia Strukturore FA/16, Bashkia Tiranë, hartuar nga individ i licencuar në arkeologji z. Gjergj Vinjahu	“A.K.2020 Construction”;



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E KULTURËS

629	28.12.2023	Miratimin e Raportit të vëzhgimit arkeologjik sipërfaqësor në kuadër të projektit “Kompleks residencial banimi 1, 2 dhe 3 kate mbitokë me 1 dhe 2 kate nëntokë”, pranë liqenit të Farkës”, Njësia Administrative Farkë, Bashkia Tiranë, hartuar nga individ i licencuar në arkeologji znj. Silvana Kita	“Blue Pond Development”;
630	28.12.2023	Miratimin e Raportit të vëzhgimit arkeologjik sipërfaqësor në kuadër të projektit “Centrali fotovoltai (2MW) Povelç 1”, Fushë Hoxharë, Bashkia Fier, hartuar nga individ i licencuar në arkeologji z. Taulant Rama	“Sun Avenue”;
631	28.12.2023	Miratimin e Raportit të vëzhgimit arkeologjik sipërfaqësor në kuadër të projektit “Strukturë me funksion hoteleri 1, 2, 3, 4 kate mbitokë dhe 4 kate nëntokë”, me vendndodhje në Dhërmi, Bashkia Himarë, hartuar nga individ i licencuar në arkeologji z. Taulant Rama	“Altea Invest”;

TRAJNIME/SEMINARE/KONFERENCA

(Të listohen trajnimet/seminare/konferenca të organizuara brenda dhe jashtë vendit, në të cilat janë pjesëmarrës staf nga institucioni juaj.)

NR	TITULLI I AKTIVITETIT	PERIUDHA	PJESËMARRËSIT (NR)	PËRSHKRIM NARATIV
1	Forumi i “Ditëve Evropiane të Arkeologjisë” në Paris, Francë. Zyrat e UNESCO, 7 Pl. de Fontenoy, 75007.	20-21 Janar 2023,	Z. Eugen Kallfani, Drejtor i Përgjithshëm, IKTK Znj. Ela Miziri, Drejtor, DSHA, IKTK	INRAP organizoi Forumin e “Ditëve Evropiane të Arkeologjisë” në Paris, Francë, në formën e një workshop-i. Qëllimi i aktivitetit ishte shkëmbimi i eksperiencave mes koordinatorëve të vendeve pjesëmarrëse në kuadër të përmirësimit të këtij aktiviteti në vijimësi.
2	Takimi për bashkëpunimin me vendet e Ballkanit perëndimor, mbi ndryshimet klimaterike dhe ruajtjen e trashëgimisë kulturore, organizuar nga Ministria e Punëve të Jashtme dhe Bashkëpunimit Ndërkombëtar në Itali	3 Prill 2023	Znj. Artilla Vavako, Përgjegjëse SQHATP, IKTK Znj. Kiara Xhelili, Përgjegjëse SMVANN, IKTK	Pjesëmarrje në takimin për bashkëpunimin me vendet e Ballkanit perëndimor, mbi ndryshimet klimaterike dhe ruajtjen e trashëgimisë kulturore, organizuar nga Ministria e Punëve të Jashtme dhe Bashkëpunimit Ndërkombëtar në Itali (Experts Round-tables on cooperation with the Eastern Balkans on climate change and preservation of the cultural heritage) Rome,
3	“Mbrotjtja e pasurive kulturore në vendet me konflikt” organizuar nga UNESCO-s në Paris-France”	12-13 Dhjetor 2023	Znj. Artilla Vavako, Përgjegjëse SQHATP, IKTK Znj. Klejdia Kore, Specialiste SQHATP, IKTK	Takim i 10-te i organizuar nga UNESCO, në selinë qendrore të tyre në Paris, midis të gjitha vendeve anëtare që kanë ratifikuar Protokollin e dytë të konventës së Hagës të vitit 1954.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E KULTURËS

4	"Workshop of Qesarati/Kestorati, in the frame of 18th century painting" në Institutin e Konservimit dhe Restaurimit, Universiteti i Arteve të Aplikuara në Vjenë, Austri.	13.11.2023 deri 01.12.2023	Znj.Era Bushi, specialiste SVA Znj.Enkejda Nesturi specialiste SVA	Programi konsiston në paraqitjen praktike të pajisjeve dhe metodologjinë e përdorimit në funksion të praktikës së restaurimit si dhe punën e konservim-restaurimit të artefakteve që përbëjnë Trashëgimi Kulturor në atelietë të Institutit të Konservimit, Universiteti i Arteve të Aplikuara në Vjenë. Ky program trajnimi ka përfshirë gjithashtu vizita si në laboratorët e Agjencisë Ndërkombëtare të Energjisë Atomike në Seibersdorf, laboratorët dhe atelietë të Vjenës (Arsenal) dhe Mauerbach (konservim-restaurimi i gurit), të Autoritetit Federal Austriak të Monumenteve (Bundesdenkmalamt, BDA). Qëllimi ishte trajnimi dhe diskutimi mbi përdorimin e XRF portabël si dhe teknikave FTIR dhe SEM-EDS në laboratorët e Institutit të Konservimit dhe Restaurimit, Universiteti i Arteve të Aplikuara. Krahas trajnimit mbi implementimin e pajisjeve të mësipërme ekspertët e IKTK kanë ndjekur leksione mbi metodologjinë dhe qasjet në shkencën e konservim-restaurimit dhe kanë kontribuar edhe me ekspertizën e tyre, duke u përfshirë në programin në aktivitetin Jour Fixe, të Institutit të Konservimit dhe Universitetit të Arteve të Aplikuara, ku u mbajt një referat, leksion i hapur përpara studentëve dhe pedagogëve të këtij Institucioni, dhe ku u relatua mbi rolin e Institutit Kombëtar të Trashëgimisë Kulturorë, si



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E KULTURËS

				institucion qendror në fushën e Trashëgimisë Kulturore, dhe njëkohësisht u prezantuan shembuj të projekteve të ndërhyrjeve të konservim/restaurimit dhe të studimit, si në pikturë murale dhe në ikona, ndërsa një temë e rëndësishme ishte projekti Workshop of Qesarati/Kestorati, in the frame of 18th century painting, përmbajtja dhe qëllimi i projektit, puna paraprake si dhe pyetjet e adresuara ndaj Institutit të Fizikës Bërthamore të Aplikuar, në laboratorët e të cilit po analizohen kampionet e marra në kishat ku ka pikturuar kjo atelie lokale.

OBJEKTIVAT E VITIT 2024

DSHA

1. Pjesëmarrje në konferencën **Forumin e Ditëve Evropiane të Arkeologjisë**, në Madrid (Muzeu Kombëtar i Arkeologjisë), Spanjë në datat 14-15 Mars, organizuar nga Ministria e Kulturës Spanjë dhe INRAP në kuadër të eventit ndërkombëtar “Ditët Evropiane të Arkeologjisë”.
2. Pjesëmarrje në konferencën vjetore të 25-të të EAC me temë **“Urban Archaeology and the Cities of Tomorrow”**, në Bruksel, Belgjikë, në datat 21-23 Mars 2024.
3. Realizimi i eventit të III promovues **“DITËT EUROPIANE TË ARKEOLOGJISË” 2024**
4. Pjesëmarrje në konferencën vjetore të 30-të të EAA me temë **“Persisting with change”** Romë, Itali, në datat 28 - 31 Gusht 2024
5. Vazhdimi i botimit të **“Revistës Arkeologjike Nr. 2”** (njoftimi për pjesëmarrje, përgatitje artikujsh etj.)



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E KULTURËS

6. Hartimi i projektit të konservimit në bashkëpunim me Sektorin e Arkitekturës Antiko – Mesjetare në lidhje me strukturat e zbuluara nga gërmimi arkeologjik për **“Rrënojat termës së periudhës romake në Belsh”**.

Spektori i Veprave te Artit

- Vazhdimin e projektit "Atelieja e Janit dhe Vasilin nga Qestorati nën kuadrin e pikturës së shek. XVIII" në bashkëpunim me IFBZ.
- Restaurimin e pese ikonave të ikonostasit te kishes se Shen Kollit ne Elbasan (shek.XVII-XVIII) të ikonografisë të shek. XVIII Ditcho Zografi në Laboratorin e Restaurimit të Veprave të Artit.
- Vazhdimin e trajtimit dhe konservimin e fragmenteve të pikturës murale marrë nga objekte të ndryshme (Kisha e Shën Todrit Kadipashaj, Bazilika Paleokristiane në Elbasan).
- Hartimin e projekteve të konservimit dhe restaurimit në pikturën murale, drurin e dekoruar (tavane dekorative, ikonostase, etj.), mozaikë, etj.
- Hapja e disa mozaikëve në kuadër të ditës së mozaikëve.
- Ekspedita informative në terren për verifikimin e gjendjes së konservimit të veprave të artit në të gjithë territorin (objekte kulti, banesa, parqe arkeologjike, etj.).
- Konferenca te ndryshme dhe Workshope per promovimin e projekteve me karakter shkencor dhe konservues.
- Vazhdimin e implementimit të marrëveshjeve me institucionet partnere të huaja për bashkëpunimin dypalësh me qëllim ruajtjen dhe promovimin e trashëgimisë tonë kulturore.
- Publikime të ndryshme me karakter studimor dhe raportues me fokus studimin, ndërhyrjet, ruajtjen, restaurimin dhe promovimin e trashëgimisë tonë kulturore.

Spektori i Arkives Teknike

- Skanimin e kartotekës në masën 100 %
- Skanimin e fototekës në masën 100 %

Spektori i Platformes Digjitale

- Ndjekja e aplikimeve në sistemin e-leje



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E KULTURËS

Në funksion të përditësimit të platformës WebGis Arkeologjia SPDTK ndjek alikimet në sistemin e-leje duke bërë kontrollin e listës së dokumentave të detyrueshme që duhen ngarkuar në sistem nga përdoruesit me kredenciale.

Për çdo aplikim, me procese arkeologjike ose jo, SPDTK do të përpunonjë ortofoto me monumentet më të afërta me zonat e parashikuara për ndërhyrje.

- **Vazhdimi i komunikimit me subjektet private të licensuara në fushën e arkeologjisë dhe institucionet e specializuara për plotësimin e dokumentacionit në sistemin WebGis Arkeologjia.**

Kërkesa me shkresë, për dorëzimin e dokumentacionin e detyrueshëm për aplikimin online, të prodhuar nga proceset arkeologjike, u është dërguar pjesës më të madhe të subjekteve private të licencuar për veprimtari arkeologjike. Për shkak të vështirësisë për të gjetur adresat fizike të disa prej tyre, kërkesa për dorëzimin e dokumentacionit, fizikisht pranë Sekretarisë Teknike të IKTK, nuk u është dërguar të gjithë subjekteve private.

Gjithashtu, duke qenë se nga verifikimi i projekteve online kanë rezultuar një sërë projektesh pa informacion është e rëndësishme të vazhdojë komunikimi me subjektet private të licencuara për plotësimin e dokumentacionit të munguar.

- **Hartimi i ToR për bashkimin e platformave WebGis të IKTK në një të vetëm dhe mirëmbajtja e tij.**

Sistemet WebGis të IKTK janë ngritur nga dy institucione të veçanta (Agjencia e Shërbimit Arkeologjik dhe Instituti i Monumenteve të Kulturës “Gani Strazimir”), të cilat në fund të vitit 2019 janë bashkuar për të formuar Institutin Kombëtar të Trashëgimisë Kulturore. Ekzistenca e dy sistemeve të ndryshme WebGis për një institucion është një kosto e shtuar për mirëmbajtjen e tyre e, gjithashtu, informacioni i ofruar në dy sisteme të ndryshme shfaqet i ndarë dhe jo i plotë. Bashkimi i sistemeve WebGis të IKTK në një të vetëm do të ishte në të mirën e institucionit, përdoruesve dhe publikut.

- **Përfundimi i procesit të standartizimit**

Procesi i standartizimit për zonat e mbrojtura do të përfshijë shfaqjen e hartës së zonave të mbrojtura dhe monumenteve në portalin kombëtar të ASIG, i cili ka krijuar një sistem të integruar të dhënash gjeohapësinore, i cili u mundëson përdoruesve identifikimin dhe përdorimin e informacionit gjeohapësinor të marrë nga burime të ndryshme, në nivel lokal dhe kombëtar, në mënyrë gjithëpërfshirëse.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E KULTURËS

- **Trajnimi i stafit**

Momentalisht SPDTK ka mangësi në stafin e tij dhe puna në sektor çohet përpara vetëm nga përgjegjësi i sektorit. Është e rëndësishme që në këtë sektor të angazhohet personel me njohuri të veçanta në programet Gis dhe stafi duhet të trajnohet vazhdimisht me të rejat e teknologjisë së aplikuar në fushat e trashëgimisë kulturore, në mënyre që të përmbushë detyrat e tij funksionale dhe të sjellë risi në dixhitalizimin e pasurisë kulturore.

- **Ngritja e grupit të punës për hartimin e V.K.M.-së për “Bazën e të dhënave GIS për veprimtarinë arkeologjike në republikën e Shqipërisë”.**

Në zbatim të ligjit 27/2018 “Për Trashëgiminë Kulturore dhe Muzetë”, Neni 35, “Baza e të dhënave GIS për veprimtarinë arkeologjike në Republikën e Shqipërisë”:

1. Informacioni i përftuar nëpërmjet hulumtimeve arkeologjike do të përfshihet në “Bazën e të dhënave GIS për veprimtarinë arkeologjike në Republikën e Shqipërisë”.
2. Krijimi dhe funksionimi i këtij sistemi përcaktohet me vendim të Këshillit të Ministrave.

Për mirëfunksionimit e platformave WebGis të IKTK, është e nevojshme ngritja e grupit të punës për hartimin e v.k.m. për “Bazën e të dhënave GIS për veprimtarinë arkeologjike në Republikën e Shqipërisë”.